

Dr. Ismail Karagöz

**Amaneti shoqëror:
personat me aftësi
të kufizuara**

Nga turqishtja:
Rehan Neziri

Kreuzlingen - 2026

Përmbajtja

Hyrje	V
I. Invaliditeti në Kur'an	2
II. Shkaqet e të qenit me aftësi të kufizuara	14
III. Detyra për parandalimin dhe trajtimin e aftësisë së kufizuar	20
IV. Fitimet shpirtërore të personave me aftësi të kufizuara	26
V. Marrëdhëniet shoqërore me personat me aftësi të kufizuara	28
Përfundim dhe vlerësim	42

Hyrje

I Lartësuar Allah i vlerëson njerëzit sipas besimit, adhurimit, devotshmërisë, veprave të mira, moralit të bukur dhe bindjes së tyre, ashtu siç i gjykon edhe sipas mohimit, politeizmit, hipokrizisë, padrejtësisë, mëkatit dhe sjelljeve të këqija të tyre. Ai nuk i vlerëson ata sipas pasurisë, racës, ngjyrës, gjinisë, gjuhës, prejardhjes, ndërtimit fizik apo faktit nëse janë të shëndetshëm apo me aftësi të kufizuara. Këtë të vërtetë e pohon fjala e Allahut të Madhëruar: *“Më fisniku ndër ju, te Allahu, është ai që është më i devotshmi.”* (el-Huxhurat, 49:13). Po ashtu, Pejgamberi s.a.v.s. ka thënë: *“Allahu nuk shikon pamjet tuaja dhe as pasuritë tuaja, por shikon zemrat tuaja (besimin apo mohimin që mbartin) dhe veprat tuaja.”* (Muslimi, el-Birr, 32).

Ajetet me kuptimin *“Ne, me të vërtetë, e kemi krijuar njeriun në formën më të bukur.”* (et-Tin, 95:4), *“Allahu ju dha formë dhe e bëri formën tuaj më të bukur.”* (et-Tegabun, 64:3), dhe *“Pastaj e përsosi krijimin e njeriut dhe i fryu nga shpirti i Tij; për ju krijoi dëgjimin, shikimin dhe mendjen.”* (es-Sexhde, 32:9) shprehin se Allahu xh.sh. i ka krijuar njerëzit në mënyrën më të bukur dhe më të përsosur.

Kjo botë, që është si një shtëpi mysafirësh, është vend sprove. Njerëzit, të cilët në këtë botë sprovohen me besimin, fjalët, veprat dhe sjelljet e tyre, mund të përballen me ngjarje të mira ose të këqija, të ëmbla ose të hidhura; ka ditë kur gëzohen dhe ditë kur trishtohen, ditë kur qeshin dhe ditë kur qajnë. Nganjëherë sprovohen me begati, e nganjëherë me vështirësi të ndryshme. Është diçka e natyrshme që kudo ku ka njeri, të ketë edhe sëmundje, derte, vështirësi e fatkeqësi. Ndoshta perla e vërtetë e durimit dhe e qëndrueshmërisë së njeriut shfaqet vetëm pas këtyre sprovave e përjetimeve. Siç thuhet në një fjalë të urtë: *“Ari njihet në zjarr, njeriu njihet në mundim (në çastin e vështirësisë).”*

Të gjithë ne, në çdo çast, jemi përballë një sprove. Ashtu siç kemi ditë të shëndetshme e të qeta, do të kemi edhe ditë të vështira e të lodhshme. Pa dyshim, tek disa njerëz vështirësitë mund të jenë më të mëdha dhe mund të zgjasin gjatë gjithë jetës. Sprovat që i vijnë njeriut ndonjëherë janë pasojë e pakujdesisë apo gabimeve të tij vetjake, ndërsa herë të tjera ndodhin pa asnjë faj apo neglizhencë prej tij - si në rastet e aksidenteve rrugore, të cilat ndodhin për shkak të njerëzve të papërgjegjshëm, të pasjellshëm dhe që nuk i respektojnë rregullat.



Ashtu si në mbarë botën, edhe në vendin tonë gjenden njerëz me pengesa mendore, psikike dhe trupore. Të jemi të ndjeshëm ndaj këtyre vëllezërve tanë, t'ua tregojmë kujdesin dhe përkrahjen e duhur, është detyra jonë njerëzore dhe islame. Sepse ndër vlerat më të rëndësishme universale të fesë sonë të lartë – Islamit – zë vend kujdesi dhe mbështetja ndaj fëmijëve, grave, të moshuarve dhe personave me aftësi të kufizuara. I dashuri Pejgamber s.a.v.s. ua ka hapur zemrën e tij të sëmurëve, të varfërve dhe atyre që kishin nevojë për përkujdesje; u

është afruar me dashuri dhe mëshirë, duke i parë ata si pjesë të pandarë të shoqërisë. Ai ka thënë: *“Përkujdesja për ata që kanë nevojë është përgjegjësi e jona.”* (Buhariu, el-Feraid, 25), me çka ka kërkuar që nevojtarëve dhe njerëzve me aftësi të kufizuara t’u dalim zot si në nivelin individual, ashtu edhe në atë shoqëror dhe shtetëror. Në një transmetim tjetër, ai e ka cilësuar ndihmën ndaj njerëzve në nevojë dhe personave me aftësi të kufizuara si një sadaka. (Ahmed b. Hanbeli, Musned, II, 350)

Termi “person me aftësi të kufizuara” nënkupton ata njerëz që, për shkak të një mangësie apo sëmundjeje në mendje, psikë, trup apo në ndonjë gjymtyrë, kanë vështirësi në vazhdimin e jetës së tyre të përditshme, në kryerjen e punëve dhe në përshtatjen me shoqërinë. Personat me aftësi të kufizuara shpesh përmenden edhe me termin “invalidë”.

Fakti që në vendin tonë (Turqi) jetojnë rreth nëntë milionë persona me aftësi të kufizuara e bën të domosdoshme që çdo individ të jetë i ndjeshëm dhe i vëmendshëm ndaj kësaj çështjeje. Sepse çdo njeri, në një mënyrë ose tjetër, është ose person me aftësi të kufizuara, ose i afërm i tij, ose një kandidat potencial për t’u bërë i tillë. Shumë njerëz, ndërsa janë të shëndetshëm, mund ta humbasin shëndetin e tyre për shkak të një aksidenti rrugor, aksidenti në punë apo sëmundjeje, duke mbetur të paralizuar, të paafte, me pengesa ortopedike, të dëmtuar në dëgjim ose në shikim.



Për këtë arsye, qoftë para se të përballemi me këtë realitet, qoftë pasi ta përjetojmë atë, duhet të jemi gjithmonë të kujdesshëm, të përgatitur dhe të vetëdijshëm.

Të dish se çfarë duhet bërë dhe si duhet vepruar përballë këtij realiteti, si dhe të jesh i informuar e i vetëdijshëm për të, është ndër detyrat themelore të individëve, familjeve, organizatave të shoqërisë civile dhe të gjitha institucioneve e organizatave. Secili duhet ta kryejë përgjegjësinë që i takon dhe, para së gjithash, të merren të gjitha masat e nevojshme në mënyrë që njerëzit tanë të mos bien në gjendje të personave me aftësi të kufizuara. Fëmijët tanë që lindin me aftësi të kufizuara ose bëhen të tillë më vonë, duhet patjetër të arsimohen, të pajisen me

mundësi pune dhe të sigurohen me mbrojtje të denjë sociale.

Rivlerësimi i të menduarit, i qëndrimit, i sjelljes dhe i qasjes sonë ndaj personave me aftësi të kufizuara, përkushtimi më i madh ndaj çështjeve dhe vështirësive të tyre, si dhe kontributi ynë për përmirësimin e arsimit dhe nivelit të jetesës së tyre, janë detyrë e secilit prej nesh - një kërkesë e njerëzisë dhe e fesë sonë.

Nga ana tjetër, personat tanë me aftësi të kufizuara duhet të jenë të vetëdijshëm për vullnetin, aftësitë dhe të drejtat e tyre; ndërsa njerëzit e shëndetshëm duhet të përpiqen t'i kuptojnë ata, t'i shohin si pjesë të pandarë të jetës dhe të arrijnë një nivel vetëdijeje që i nxit t'ua hapin mundësitë dhe shanset e tyre.

Të qenët invalid ose me aftësi të kufizuara nuk përbën pengesë në aspektin e të drejtave dhe lirive njerëzore. Çdo njeri, qoftë me aftësi të kufizuara apo i shëndetshëm, duhet ta zotërojë në mënyrë të barabartë dinjitetin dhe mirësinë e të qenit njeri.

T'u ngarkosh personave me aftësi të kufizuara përgjegjësi në përpjesëtim me mundësitë dhe aftësitë e tyre është një kërkesë e respektit ndaj të drejtave të njeriut, e drejtësisë dhe e barazisë. Burimin e problemit të personave me aftësi të kufizuara në shoqërinë tonë nuk duhet ta kërkojmë te vetë ata, por më tepër tek ata që nuk janë të kufizuar.

Në këtë punim do të trajtohen qëndrimi i Librit tonë të Lartësuar, Kur'anit, ndaj personave me aftësi të kufizuara,

shkaqet e kufizimeve trupore apo mendore, përfitimet shpirtërore që sjell kjo gjendje dhe marrëdhëniet shoqërore me ta.



I. Invaliditeti në Kur'an

Në Kur'an përmenden personat me pengesa në shikim, dëgjim, të folur, me pengesa trupore e mendore, si edhe sëmundjet e ndryshme. Shumica e ajeteve që flasin për sëmundjet dhe për kufizimet në dëgjim, shikim, të folur dhe të kuptuar, kanë kuptim metaforik; ndërsa ajetet që i trajtojnë pengesat trupore ose sëmundjet në kuptimin fizik janë shumë të pakta. Si shembull mund ta përmendim kufizimin në shikim.

Kufizimin në shikim, Kur'ani famëlartë e përmend në 28 ajete, dhe në tri kuptime të ndryshme: kufizimi në shikim në kuptimin fizik, kufizimi në shikim në kuptimin metaforik, dhe kufizimi në shikim në ahiret.

A) Kufizimi në shikim në kuptimin fizik

Kufizimi fizik në shikim nënkupton që të dy sytë të mos shohin që nga lindja ose humbjen e aftësisë për të parë më vonë gjatë jetës. Në këtë kuptim, kufizimi në shikim përmendet në Kur'an në kontekstin e përngjasimeve, lehtësimeve fetare, marrëdhënieve shoqërore, vlerësimit të njeriut dhe trajtimit (shërimit). Për ilustrim, mund t'i përmendim shkurtimisht disa nga këto aspekte.

a) Në kontekstin e përngjasimit

I Lartësuari Allah i përngjason ata që mohojnë dhe bëjnë mëkat me ata që janë të verbër e të shurdhër, ndërsa ata që besojnë dhe bëjnë vepra të mira me ata që shohin dhe dëgjojnë.

“Këta dy grupe janë si i verbri dhe i shurdhëri, krahasuar me atë që sheh dhe dëgjon. A janë vallë të barabarta këto dy gjendje? A nuk mendoni?” (Hud, 11:24)

Në këtë ajet bëhet vetëm një përngjasim dhe përshkrim gjendjeje; nuk ka asnjë nënvlerësim apo përçmim ndaj personave me pengesa në shikim apo dëgjim.

Në ajetet 18–22 të kësaj sureje flitet për ata që trillojnë gënjeshtër kundër Allahut xh.sh., që i pengojnë njerëzit nga rruga e Tij, që përpiqen ta shtrembërojnë atë rrugë dhe që e mohojnë ahiretin; këta janë njerëz që e humbasin veten në këtë botë dhe do të jenë të humbur edhe në botën tjetër. Ndërsa në ajetin 23 përmenden ata që besojnë, bëjnë vepra të mira dhe i përkushtohen me respekt e frikë të singertë Allahut xh.sh. Pas këtyre përshkrimeve, në ajetin 24, mohuesit përngjasohen me persona të verbër që nuk mund ta shohin realitetin dhe nuk janë në gjendje ta gjejnë rrugën e drejtë, si dhe me të shurdhër që nuk dëgjojnë dhe nuk mund t'i përgjigjen thirrjes së të vërtetës; ndërsa besimtarët përngjasohen me ata që shohin me sy dhe dëgjojnë me veshë.

Ashtu siç nuk është i barabartë ai që sheh me atë që nuk sheh, apo ai që dëgjon me atë që nuk dëgjon në kuptimin

fizik, po ashtu as jobesimtari dhe besimtari nuk janë të barabartë në sytë e Allahut xh.sh. Këtu i Lartësuari Allah nuk e përmend shembullin e atij që sheh dhe të verbrit, të atij që dëgjon dhe të shurdhërit për t'i nënvlerësuar ata që kanë pengesa fizike, por për ta vendosur në mënyrë të qartë në mendjet tona dallimin midis gjendjes së jobesimtarit dhe të besimtarit. Në sytë e Allahut, një besimtar me pengesa në shikim apo dëgjim është më i nderuar dhe më i vlefshëm sesa një jobesimtar që ka sy e veshë të shëndetshëm, është i pasur dhe i respektuar në shoqëri. Kjo e vërtetë shprehet qartë në suren 'Abese.

b) Në kontekstin e marrëdhënieve shoqërore

"Nuk ka pengesë për të verbërin, nuk ka pengesë për të çalin dhe nuk ka pengesë për të sëmurin..." (en-Nur, 24:61)

Në cilat çështje nuk ka pengesë për personat me aftësi të kufizuara? Librat e tefsirit (komentimit të Kur'anit), si shkak të zbritjes së këtij ajeti, përmendin këto çështje:

1. Kur muslimanët dilnin në udhëtim, ata ua linin çelësat e shtëpive të tyre personave të verbër, atyre me pengesa trupore dhe të sëmurëve, duke u kërkuar që të kujdeseshin për shtëpitë e tyre. Këta njerëz, nga ndjenja e ndershmërisë dhe kujdesit, hezitonin të hanin e të pinin nga ato shtëpi që i ruanin. Atëherë i Lartësuari Allah e shpalli këtë ajet dhe u dha atyre lehtësim në këtë çështje.

2. Kur zbriti ajeti me kuptimin: *"O ju që besuat! Mos e hani pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të padrejtë."* (el-Bekara,

2:188), muslimanët thanë: “Allahu na e ndaloj ta hamë pasurinë e njëri-tjetrit në mënyrë të padrejtë. Ushqimi është pasuria më e çmuar; prandaj askujt prej nesh nuk i lejohet ta hajë ushqimin e tjetrit”. Kështu, ata filluan ta shmangnin ngrënien në shtëpitë e të tjerëve. Atëherë Allahu xh.sh. e shpalli këtë ajet (en-Nur, 24:61) për t’u dhënë sqarim dhe lehtësim në këtë çështje.



3. Para hixhretit të Pejgamberit s.a.v.s., banorët e Medinës hezitoin të hanin bashkë me personat e verbër, me kufizime ortopedike dhe me të sëmurët; madje nuk

uleshin në të njëjtën sofër me ta. Atëherë Allahu xh.sh. e shpalli këtë ajet, duke bërë të ditur se nuk ka asnjë të keqe që njerëzit e shëndetshëm të hanë bashkë me personat e verbër, me kufizime ortopedike e me të sëmurët, as nuk ka ndonjë pengesë që personat me aftësi të kufizuara të hanë nga ushqimi i tyre.

4. Ky ajet ka zbritur në lidhje me personat me aftësi të kufizuara që nuk mund të merrnin pjesë në xhihad në rrugën e Allahut xh.sh.; për ta është dhënë lehtësim (*ruhsat*) në këtë çështje. (Taberiu, *Xhami'u'l-Bejan 'an Te'vili Aji'l-Kur'an*, X, 18/168–169, Bejrut, 1988).

c) Në kontekstin e lehtësimit (*ruhsat*)

“Nuk ka mëkat (pengesë) për të verbërin, nuk ka mëkat për të çalin dhe nuk ka mëkat për të sëmurin...” (Fet'h, 48:17)

Ky ajet ka të bëjë me përjashtimin e personave me aftësi të kufizuara nga detyrat që i tejkalojnë fuqitë e tyre, si për shembull pjesëmarrja në luftë. Në ajet nuk thuhet se personat me aftësi të kufizuara nuk mbajnë përgjegjësi për detyrimet fetare, por se për ta është dhënë lehtësim dhe leje (*ruhsat*), duke treguar se ata janë përgjegjës për detyrat fetare vetëm në përpjesëtim me mundësitë e tyre. Asnjë pengesë fizike nuk e pengon njeriun të jetë në shërbim dhe adhurim të Allahut; megjithatë, Islami i ngarkon njerëzit me përgjegjësi vetëm aq sa kanë fuqi (el-Bekara, 2:284).

d) Në kontekstin e vlerësimit

Njeriu i verbër që i drejtohet Allahut xh.sh. dhe Pejgamberit s.a.v.s. është më i vlefshëm sesa njeriu i pasur dhe me pozitë që mohon dhe bën mëkat. Kjo çështje shprehet qartë në dymbëdhjetë ajetet e para të sures Abese (80). I Dërguari ynë s.a.v.s. zhvillonte një bisedë të veçantë me disa prej të pasurve dhe parësisë së Mekës, si Ebu Xhehli (Amr b. Hisham), Umejje b. Ebi Halefi, Abbas b. Abdulmuttalibi dhe Utbe b. Ebi Rebia, duke i ftuar ata në Islam. Për shkak të rëndësisë së tyre shoqërore, ai dëshironte shumë që këta njerëz ta pranonin Islamin, me qëllim që çështja e Islamit të forcohej. Ndërsa i Dërguari s.a.v.s. po fliste me Umejje b. Halefin, erdhi një njeri i verbër nga fisi Fihri, i quajtur Abdullah b. Ummi Mektum, dhe i kërkoi Pejgamberit s.a.v.s. t'ia lexonte një ajet nga Kur'ani. Ai tha: "O i Dërguari i Allahut! Më mëso edhe mua nga ato që Allahu të ka mësuar ty!" Pejgamberit s.a.v.s. nuk i pëlqeu që t'i ndërpritej fjala; ai e ngrysi fytyrën, u zmbraps prej tij dhe u kthye sërish nga të tjerët. Kur mbaroi së foluri dhe u ngrit për t'u larguar, zbriti shpallja dhe ajetet përkatëse të sures Abese, të cilat lidhen me këtë ngjarje.

"Ai vrenjti (fytyrën) dhe u kthye. Ngase atij i erdh i verbëri. E ku mund ta dish ti, ndoshta ai do të pastrohet. Apo do të këshillohet dhe këshilla do t'i bëjë dobi! E ai që nuk ndien nevojë (për Zotin) pse ka pasuri, ti atij ia vë veshin (i drejtohesh)! Po ti nuk ke përgjegjësi, pse ai nuk pastrohet. Ndërsa ai që nxiton dhe vjen te ti, dhe meqë ai

frikësohet, e ti nuk e zë asgjë (dhe nuk ia vë veshin fjalës së tij). Jo ashtu! Në të vërtetë këto janë këshilla. Kush do, merr mësim nga kjo (nga Kur'ani)." (Kur'ani, 80:1-12)

Pas kësaj ngjarjeje, i Dërguari ynë s.a.v.s. tregoi nderim të veçantë ndaj Abdullah b. Ummi Mektumit: bisedonte me të, e pyeste për gjendjen e tij dhe nëse kishte ndonjë nevojë, duke u kujdesur për të. Abdullah b. Ummi Mektumi ishte djali i dajës së bashkëshortes së Pejgamberit (s.a.v.s.), hz. Hatixhes. Ai ishte ndër të parët që migruan në Medinë. Së bashku me Pejgamberin s.a.v.s. ka marrë pjesë në dy beteja. Pejgamberi s.a.v.s. e ka lënë atë si zëvendës të vetin në Medinë trembëdhjetë herë. Ai e ka kryer detyrën e imamit për xhematin. Abdullah b. Ummi Mektumi ishte edhe një nga muezinët e të Dërguarit (s.a.v.s.). Enes b. Maliku ka thënë se e ka parë në betejën e Kadisijes me një flamur të zi në dorë dhe të veshur me parzmore. Thuhet se ai ka rënë dëshmor në këtë betejë (Taberiu, XV, 30/50-52).

e) Në kontekstin e shërimit

Në dy ajete të Kur'anit bëhet e ditur se Isai a.s., me lejen e Allahut xh.sh., i shëronte personat që kishin lindur me mangësi fizike (Alu Imran, 3:49).

B) Pengesa në shikim në kuptimin metaforik

Pengesa metaforike në shikim nuk nënkupton mospamjen e objekteve me sy, por pamundësinë e njeriut për ta parë të vërtetën, pra nënkupton “verbërinë e zemrës”. Kur e shikojmë Kur’anin, vërejmë se jobesimtarët, idhujtarët dhe hipokritët shpesh quhen “të verbër”. Për shembull, në ajetin me kuptimin: *“A është i barabartë ai që sheh me atë që nuk sheh?”* (er-Ra’d, 13:16), “i verbri” dhe “ai që sheh” janë terma metaforikë, me të cilët nënkuptohen: jobesimtari dhe besimtari, i padituri dhe i dituri, idhulli dhe Allahu, i pavëmendshmi dhe ai që e sheh të vërtetën. Po kështu, në ajetin me kuptimin: *“A është i barabartë i verbri me atë që sheh?”* (el-En’am, 6:50), me “të verbërin” nënkuptohet idhujtari që i bën shok Allahut, ndërsa me “atë që sheh” - besimtari që e pranon Allahun si Një dhe të Vetëm.

Ashtu siç quhet “verbëri” humbja e aftësisë së syve për të parë, po ashtu quhet “verbëri” edhe pamundësia e zemrës për t’i kuptuar të vërtetat. Në gjuhën tonë, në shprehjen “nuk është i verbër, por i sheh të gjitha”, fjala “i verbër” përdoret pikërisht në këtë kuptim metaforik. Në Kur’an, nga gjithsej 29 ajete ku përmendet “verbëria” në formë emri ose foljeje, 25 prej tyre i referohen verbërisë së zemrës. I Lartësuarit Allah na e bën të ditur se verbëria e vërtetë është verbëria e syrit të zemrës (el-Haxh, 22:46).

Verbëria e syrit të zemrës është pamundësia për t’i parë e kuptuar të vërtetat, për të nxjerrë mësim nga ngjarjet, tregimet dhe krijesat. Njeriu që e ka syrin e zemrës të

verbër nuk është në gjendje ta dallojë të vërtetën nga e kota, të drejtën nga e shtrembra, udhëzimin nga humbja. Ai nuk mund të largohet nga *kufri* (mosbesimi), *shirku* (idhujtaria) dhe *nifaku* (hipokrizia), e të drejtohet kah besimi (*imani*). Njeriu që me sytë e jashtëm i sheh krijesat por nuk merr mësim prej tyre, që nuk i sheh argumentet që tregojnë për ekzistencën e Krijuesit të Lartësuar, që nuk e gjen të vërtetën dhe rrugën e drejtë - sipas Kur'anit - është "i verbri i vërtetë".

C) Pengesa në shikim në botën tjetër (Ahiret)

Në Kur'an përmenden persona që do të jenë të verbër në botën tjetër:

"E kush ia kthen shpinën udhëzimit Tim, do të ketë jetë të vështirë dhe në Ditën e Kijametit do ta ringjall të verbër. Ai (që nuk besoi) do të thotë: 'Zoti im, prse më ngrite të verbër, kur unë isha me sy?' Ai (Allahu) thotë: 'Ashtu si harrove ti argumentet Tona që t'i ofruam, ashtu je ti i harruar sot.'" (Ta-ha, 20:124-126)

"Atë që Allahu e drejton në rrugë të drejtë, ai është udhëzuar, e atë që e lë të humbur, për atë nuk do të gjesh ndihmëtar tjetër përveç Atij. Në Ditën e Kijametit Ne i tubojmë ata duke i tërhequr rrëshqanas me fytyra për dhe, të verbër, memecë, të shurdhët..." (el-Isra', 17:97)

Dijetarët e tefsirit kanë pasur mendime të ndryshme nëse verbëria në botën tjetër është reale apo metaforike. Sipas

atyre që thonë se është në kuptimin metaforik, me “verbëri” nënkuptohet pamundësia e jobesimtarëve për t’i parë gjërat që do t’i gëzonin ata. Ndërsa sipas atyre që e marrin verbërinë në kuptimin fizik dhe real, jobesimtarët - pas urdhrit të përmendur në suren el-Mu’minun (23:108) - do të jenë të verbër, të shurdhër dhe memecë. (Krahaso: el-Kehf, 18:53; el-Furkan, 25:12; el-Mulk, 67:7)

I Lartësuari Krijues ka krijuar te çdo njeri dy lloje sysh: “sytë e dukshëm” (sytë e ballit) dhe “sytë e padukshëm” (sytë e zemrës). Këta të dytët, në gjuhën e Kur’anit, quhen “basar” dhe “basiret”. (el-Isra, 17:36; el-Kijameh, 75:14)

Njeriu, me sytë e ballit, mund t’i shohë krijesat dhe sendet e prekshme të kësaj bote. Mirëpo me këta sy nuk mund të shihen Krijuesi ynë, shpirti, mendja, ndjenjat, ndërgjegjja, melekët, xhinët dhe shumë krijesa të tjera.

Mijëra argumentet në këtë botë që dëshmojnë për ekzistencën e Krijuesit të Lartësuar - stinët, planetët, rendi i përsosur në botën e bimëve dhe kafshëve, krijimi i mrekullueshëm i njeriut, shumë ngjarje që ndodhin në natyrë dhe dukuri të shumta që vërehen në jetën shoqërore - nuk mund të shihen vetëm me sytë e ballit, ato shihen me sytë e zemrës. Krahas atyre që dinë t’i përdorin si sytë e ballit, ashtu edhe ata të zemrës, ka edhe njerëz që mjaftohen vetëm me sytë e jashtëm, duke i përdorur shumë pak ose aspak sytë e zemrës. Populli ynë këta njerëz i quan “pa basiret”. Ndërsa në Kur’an, këta quhen “të verbër të zemrës”, siç thuhet: *“Në të vërtetë, nuk*

verbërohen sytë, por verbërohen zemrat që janë në gjokse.”
(el-Haxh, 22:46)

Mbyllja e syve të ballit dhe pamundësia për t'i parë krijesat në këtë botë është e vogël dhe e parëndësishme krahasuar me mbylljen e syve të zemrës dhe pamundësinë për t'i parë të vërtetat hyjnore. Nëse sytë e zemrës shohin, ndërsa sytë e jashtëm nuk shohin, kjo nuk i sjell njeriut asnjë dëm në jetën shpirtërore dhe në ahiret. Por nëse sytë truporë shohin, ndërsa sytë e zemrës janë të verbër, kjo nuk i jep njeriut asnjë dobi në botën tjetër. Njeriu që e humb shikimin e jashtëm në këtë botë të përkohshme e të shkurtër, por nuk e ka humbur shikimin e zemrës, ai do të mund të shohë në ahiret, që është i vërtetë dhe i përhershëm. Por ai që e ka humbur shikimin e zemrës dhe nuk është më i aftë t'i shohë të vërtetat, nuk do të jetë në gjendje ta shohë as xhenetin, as begatitë, as ndonjë bukuri tjetër në botën tjetër. I njëjti fund i pret edhe ata që nuk e përdorin mendjen, gjuhën dhe veshët e tyre për ta njohur të vërtetën.

II. Shkaqet e të qenit me aftësi të kufizuara

Përse njerëzit lindin ose bëhen më vonë me aftësi të kufizuara? Cili është shkaku i kësaj? Kur shohim në Kur'an, vërejmë se në pengesat mendore apo trupore - si në shikim, dëgjim, të folur, të menduar e të kuptuar - ndikojnë dy faktorë kryesorë: 1. vullneti hyjnor dhe sprova, 2. pakujdesia dhe gabimet e vetë njerëzve.

a) Vullneti hyjnor dhe sprova

Çdo fatkeqësi, qoftë materiale apo shpirtërore, që prek pasurinë apo jetën e njerëzve - e madhe apo e vogël - ndodh vetëm me lejen dhe vullnetin e Allahut xh.sh. Pa lejen dhe vullnetin e Tij, as dëshira dhe as përpjekja e askujt nuk mund t'i sjellë njeriut ndonjë aksident, fatkeqësi apo sprovë.

Këtë të vërtetë e shpreh ajeti me kuptimin: *“Asnjë fatkeqësi nuk ndodh pa lejen e Allahut.”* (et-Tegabun, 64:11)

Çdo gjë që e trishton ose e mërzit njeriun është një *musibet* (fatkeqësi). Prandaj, çdo mangësi apo sëmundje në ndonjë pjesë të trupit të njeriut është një musibet, dhe ky musibet ka ndodhur me lejen, vullnetin dhe caktimin e Allahut xh.sh. Pa lejen, vullnetin dhe caktimin e Allahut xh.sh., jo vetëm që nuk është e mundur të ndodhë ndonjë dëm apo

sëmundje në trupin e njeriut, por as vdekja e tij nuk mund të ndodhë. (Alu Imran, 3:145)

Musibetet që i godasin njerëzit mund të jenë edhe një sprovë hyjnore. Këtë të vërtetë e shprehin këto ajete:

“Ne do t’ju sprovojmë me ndonjë frikë, me uri, me ndonjë humbje nga pasuria e nga jeta e edhe nga frytet, por ti përgëzoji durimtarët.” (el-Bekara, 2:155)

“Çdo krijesë do ta shijojë vdekjen, e Ne, në shenjë sprove ju sprovujmë me të keqe e me të mirë, dhe ju ktheheni te Ne.” (el-Enbija’, 21:35)



Në të vërtetë, me jetën dhe vdekjen e tij, njeriu është vazhdimisht në gjendje sprove. (Shih el-Mulk, 67:2; el-Kehf, 18:7; Hud, 11:7)

Duhet ta dimë dhe ta besojmë me bindje të plotë se Ai që e ka krijuar gjithësinë dhe çdo gjë të gjallë e të pajetë në të (el-En'am, 6:102), Ai që jep jetën (el-Hadid, 57:2), Ai që furnizon me rizk (er-Rum, 30:40), Ai që vendos rregullin dhe masën (el-Furkan, 25:2), Ai që jep vdekjen dhe ringjall, Ai që bën të qeshë dhe të qajë (en-Nexhm, 53:43-44), është Allahu xh.sh. Ai bën çfarë të dojë. Lindjet, vdekjet, dukuritë natyrore, fatkeqësitë dhe musibetet - shkurt, çdo gjë e mirë apo e keqe, çdo e dobishme apo e dëmshme - ndodh me lejen dhe vullnetin e Tij. Prandaj, fatkeqësitë që e dëmtojnë jetën dhe pasurinë e njerëzve, si dhe çdo lloj musibeti, ndodhin vetëm me lejen dhe caktimin e Allahut xh.sh.

Nga ana tjetër, ruajtja e shëndetit, e jetës dhe e pasurisë, shmangia nga rreziqet dhe marrja e masave mbrojtëse janë urdhër, imperativ i Allahut xh.sh. Megjithatë, pavarësisht nga të gjitha masat që mund t'i marrë njeriu, ai prapëseprapë mund të përballet me musibet.

Musibetet që i ndodhin njeriut janë pjesë e një caktimi hyjnor. Këtë e shohim të theksuar në shumë ajete të Kur'anit. Ajetet në vijim e ndriçojnë mjaftueshëm këtë çështje:

"Thuaj: 'Neve nuk na godet asgjë tjetër, përveç çka na ka caktuar Allahu; Ai është ndihmëtar yni'. Prandaj, vetëm Allahu le t'i mbështeten besimtarët." (et-Teubeh, 9:51)

“Nuk ndodh asnjë fatkeqësi në tokë e as në trupin tuaj, e që të mos jetë në shënime (libër - Levhi Mahfudh) para se të ngjajë ajo, e kjo për Allahun është e lehtë.” (el-Hadid, 57:22)

Në këto ajete bëhet e ditur se të gjitha musibetet që e godasin tokën dhe njerëzit janë të shkruara më parë në një Libër, pra në *Levhi Mahfudh*, ku është regjistruar dija hyjnore. Ndërsa arsyen se përse çdo gjë është shkruar më parë në një Libër, i Lartësuari Allah e shpjegon kështu:

“Ashtu që të mos dëshproheni tepër për atë që u ka ikur, e as të mos gëzoheni tepër me atë që Ai u ka dhënë...” (el-Hadid, 57:23)

Në këtë ajet, Allahu xh.sh. kërkon qartë që njerëzit, përballë musibeteve, të mos pikëllohen tej mase dhe të mos bërtasin me vajtime, sepse gjithçka që ka ndodhur, ka ndodhur me lejen dhe me caktimin e Allahut xh.sh. Nuk ka dobi që njeriu të pikëllohet duke thënë: “Pse ndodhën këto? Pse më ndodhën mua?” Ajo që i takon njeriut është të thotë: “Këto musibete kanë ndodhur me caktimin e Allahut” dhe të tregojë durim dhe qëndrueshmëri. Ndërkaq, të jesh i duruar nuk do të thotë të mos marrësh masa parandaluese përballë musibeteve, e as të mos e bësh atë që duhet bërë pas ndodhjes së tyre.

b) Pakujdesia dhe gabimet e njerëzve

Në ndodhjen e musibeteve që e dëmtojnë pasurinë dhe jetën, ku manifestohet vullneti, caktimi dhe prova

hyjnore, i Lartësuarit Allah në shumë ajete na e bën të ditur se edhe sjelljet e njerëzve kanë ndikim.

Për shembull ajeti në vazhdim e shfaq këtë të vërtetë: *“Çfarëdo e keqe që mund t’ju godasë, ajo është pasojë e veprave tuaja (të këqia), e për shumë të tjera Ai ua falë.”* (esh-Shura, 42:30)

Shumë ajete dhe hadithe tregojnë se si shkak i musibeteve që u ndodhin njerëzve janë gabimet, mangësitë dhe veprat e këqija që ata i kryejnë.

Edhe njeriu besimtar, nëse në këtë botë nuk u përmbahet ligjeve hyjnore, rregullave universale dhe shoqërore - për shembull, nëse nuk kujdeset për shëndetin, ushqimin dhe pastërtinë - mund të sëmuret; nëse nuk i respekton rregullat e trafikut, mund të pësojë aksident dhe, si pasojë e sëmundjes apo aksidentit, mund të mbetet me aftësi të kufizuara. Në këto raste, njeriu duhet ta kërkojë fajin tek vetja. Nga këndvështrimi i besimtarit, edhe pse këto ndodhin me lejen e Allahut xh.sh., nuk është e drejtë të konsiderohen si dënim nga Ai.

Edhe pejgamberët janë përballur me musibete. (shih: Tirmidhiu, Zuhd, 56; Ibnu Maxhe, Fiten, 23). Për shembull, pejgamberi Jakub a.s. e humbi shikimin, pejgamberi Ejub a.s. u sprovua me sëmundje shumë të rënda. Edhe Pejgamberi ynë i dashur Muhammedi s.a.v.s. nga banorët e atjeshëm u qëllua me gurë në Taif, këmbët e tij u mbuluan me gjak; në betejën e Uhudit iu thye një dhëmb

dhe iu plagos fytyra. Ndërkohë, pejgamberët janë njerëz pa mëkate.

Prandaj, nuk është e drejtë që pas çdo musibeti të kërkohet patjetër një mëkat apo faj.

Atëherë, përse pejgamberët u përballën me musibete? Ata u përballën me to sepse ishin dërguar si shembull dhe udhërrëfyes për njerëzimin. Duke treguar durim dhe qëndresë përballë musibeteve, ata u bënë model për njerëzit.

III. Detyra për parandalimin dhe trajtimin e aftësisë së kufizuar

Qëllimi i fesë së vërtetë, që pejgamberët ua kanë përcjellë njerëzve, është mbrojtja e pasurisë, e jetës, e nderit (dinjitetit dhe personalitetit), e pasardhësve dhe e fesë.

Për ruajtjen e jetës, ashtu siç janë ndaluar vrasja e njeriut dhe vetëvrasja (el-Isra, 17:33; en-Nisa, 4:29-30, 93), po ashtu janë ndaluar edhe sjelljet që e dëmtojnë shëndetin e njeriut dhe e çojnë në sëmundje. Për shembull: konsumimi i ushqimeve helmuese, të dëmshme, të prishura ose me afat të skaduar (shih: Tirmidhiu, et-Tibb, 7), përdorimi i alkoolit dhe i drogave (shih: Tirmidhiu, et-Tibb, 8), ushqyerja e pamjaftueshme dhe e pabalancuar, moskujdesi ndaj të ftohtit dhe të nxehtit, mosrespektimi i pastërtisë dhe i masave parandaluese të mjekësisë, mosshmangia e sjelljeve që shkaktojnë aksidente, si dhe mosrespektimi i rregullave të punës dhe të trafikut - të gjitha këto janë të ndaluara. Këto mangësi përfshihen në kuptimin e ajetit: *“Mos e hidhni veten tuaj me duart tuaja në rrezik.”* (el-Bekare, 2:195) si dhe në kuptimin e ajetit: *“Mos e vrisni veten tuaj.”* (en-Nisa, 4:29)

Të gjitha detyrimet fetare mund të përmbushen vetëm kur njeriu është i shëndetshëm. Njeriu i sëmurë nuk mund të

agjërojë, nuk mund ta kryejë haxhin dhe nuk mund të punojë në rrugën e Allahut. Kusht për përgjegjësinë fetare është shëndeti i mendjes. Të gjitha këto tregojnë se sa rëndësi të madhe Islami i kushton ruajtjes së shëndetit. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka thënë: *“Shfrytëzohini për vepra të mira pesë gjëra para se të vijnë pesë të tjera.”* Dhe ndër këto pesë, ai e ka përmendur sëmundjen që e dobëson njeriun. (Tirmidhiu, ed-Deavat, 106; Ahmedi, I, 3, 78)

Njeriu është i prirur të sëmuret, *“sepse është krijuar i dobët”* (en-Nisa, 4:28). Prandaj, edhe kur i kushton kujdes ushqimit, pijes, veshjes dhe rregullave të shëndetit, ai përsëri mund të sëmuret ose të pësojë ndonjë aksident e të lëndohet. Në këtë mund të ketë faj vetë njeriu ose njerëz të tjerë, por mund të jetë edhe një sprovë hyjnore (el-Bekara, 2:155).

Islami këshillon që, përballë sëmundjeve, paaftësive dhe musibeteve të ngjashme, njeriu të tregojë qëndrueshmëri, të luftojë kundër tyre dhe t'i marrë të gjitha masat e nevojshme. Qoftë sëmundje trupore apo psikike, cilado sëmundje që ta godasë njeriun, ai duhet patjetër ta kapë rrugën e trajtimit dhe shërimit. Sepse sipas Islamit, kur njeriu sëmuret, duhet t'i bëjë dy gjëra njëkohësisht: Të kërkojë shërim nga Allahu xh.sh. dhe t'i drejtohet mjekimit material.

a) Kërkimi i shërimit nga Allahu xh.sh.

Kur njeriu sëmuret, duhet të kërkojë shërim nga Allahu xh.sh. dhe të lutet për shërim. (shih: Buhariu, et-Tibb, 34–

39). Sepse Ai që e jep sëmundjen është edhe Ai që e jep shërimin, dhe Ai që e ka vendosur shërimin në barna është po ashtu Allahu xh.sh. Ajeti me kuptimin: *“Dhe kur sëmurem, Ai (Allahu) më shëron.”* (esh-Shu’ara, 26:80) e shpall qartë se shëruesi është Allahu xh.sh. Hz. Aishja r.a. tregon se Pejgamberi ynë s.a.v.s., kur sëmurej ndonjë nga anëtarët e familjes së tij, e ledhatonte të sëmurin me dorën e djathtë dhe lutej duke thënë: *“O Zot i njerëzve! Largoje këtë sëmundje dhe jep shërim. Shërimin e jep vetëm Ti; nuk ka shërim tjetër përveç shërimit Tënd. Jepi këtij të sëmuri një shërim të tillë që të mos i mbetet asnjë gjurmë sëmundjeje.”* (el-Buhariu, el-Merda, 20, 38, 40; Muslimi, es-Selam, 46–49).

Lutja drejtuar Allahut xh.sh. për shërim si dhe leximi i ajeteve të lutjes dhe shërimit ia rrisin moralin të sëmurit dhe e përshpejtojnë shërimin.

Sëmundjet, përveç shkaqeve materiale, kanë edhe shkaqe shpirtërore. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka thënë: *“Syri i keq (mësyshja) është i vërtetë.”* (Buhariu, et-Tibb, 36; Ebu Davudi, et-Tibb, 38, 79), duke treguar kështu se sëmundja mund të ketë edhe një shkak shpirtëror.

Sot është një fakt i njohur se, krahas shkaqeve materiale, edhe shkaqet shpirtërore të sëmundjeve mendore dhe psikologjike po hulumtohen, dhe se pacientët po trajtohen duke u marrë parasysh edhe këto dimensionë. Trajtimi përmes sugjestionit dhe terapisë me muzikë është një metodë që zbatohet prej kohësh dhe nga e cila janë arritur

rezultate të mira. (shih: Adnan Çoban, *Müzik Terapi, Ruh Sağlığı için Müzikle Tedavi*, Timaş, Stamboll, 2005)

Lidhja e njerëzve me Allahun xh.sh., besimi i tyre se shërimit të vërtetë e jep vetëm Ai, si dhe gjendja e mirë shpirtërore dhe morale, kanë një rëndësi të veçantë edhe në trajtimin e sëmundjeve materiale. Pikërisht për shkak të rëndësisë së gjendjes morale, lutja (*du'aja*) luan një rol të rëndësishëm në shërim, qoftë në rastet kur mjekësia nuk ka mundësi trajtimi, qoftë si faktor ndihmës krahas trajtimit mjekësor.

b) Drejtimi për trajtim material

Së bashku me kërkimin e shërimit nga Allahu xh.sh., është e domosdoshme t'i drejtohem edhe trajtimit material: të përdoren ilaçet, kur është e nevojshme të mbahet dietë, të kryhet ndërhyrje kirurgjikale dhe të bëhet gjithçka që kërkon mjekësia bashkëkohore. Dëshmi për këtë është rasti kur një sahabi e pyeti Muhammedin a.s.: *"O i Dërguari i Allahut! A të mjekohemi?"*, Pejgamberi ynë s.a.v.s. u përgjigj: *"O robër të Allahut, mjekohuni! Sepse i Lartësuari Allah nuk ka krijuar asnjë sëmundje pa e krijuar bashkë me të edhe shërimin."* (Ebu Davudi, et-Tibb, 1; Tirmidhiu, et-Tibb, 2) Sipas kësaj, të mjekohesh është një detyrë fetare, ndërsa braktisja e mjekimit përbën një përgjegjësi të rëndë.

Edhe pengesat në shikim, dëgjim, të folur dhe të ngjashme janë sëmundje që mund të trajtohen. Për shembull,

njerëzit që nuk shohin për shkak të perdes (kataraktit) të syrit, sot mund të shërohen lehtësisht përmes operacionit.

Thelbësore është që prindërit t'i rrisin fëmijët e tyre me kujdes të madh dhe të tregojnë përpikëri që ata të mos bëhen me aftësi të kufizuara. Edhe individët duhet t'u kushtojnë vëmendje faktorëve që mund të shkaktojnë aftësi të kufizuara. Për shembull, duhet t'i respektojnë rregullat e trafikut dhe të vendit të punës, si dhe t'i shmangin varësitë si duhani, alkooli dhe drogat, të cilat e dëmtojnë mendjen dhe mund të çojnë në kufizime mendore. Nëse njerëzit, pavarësisht nga gjithçka, janë bërë me aftësi të kufizuara dhe trajtimi nuk është më i mundur, atëherë ajo që feja këshillon është që këta njerëz të jenë të duruar dhe të qëndrueshëm, ta pranojnë jetën në këtë gjendje, të dinë se me këtë po i shërbejnë Allahut xh.sh., po fitojnë sevap dhe se shkalla e tyre shpirtërore do të rritet.

IV. Fitimet shpirtërore të personave me aftësi të kufizuara

Rënia e njeriut në sëmundje, në invaliditet apo në një vështirësi trupore ose shpirtërore, me kusht që ai të tregojë durim dhe qëndrueshmëri dhe të mos bjerë në mohim e kryengritje, bëhet shkak për faljen e tij dhe për ngritjen e gradëve të tij në ahiret.

1. Bëhen shlyerje për mëkatet

“Çdo dhimbje, lodhje, sëmundje, trishtim, madje edhe një shqetësim i vogël që i ndodh një besimtari, bëhet shlyerje për një pjesë të mëkateve të tij.” (Muslimi, el-Birr, 52)

“Nuk ka asnjë vështirësi që i ndodh një muslimani - madje as shpimi i një gjembi në këmbë - e që Allahu të mos e bëjë atë shlyerje për mëkatet e tij.” (Buhariu, el-Merda, 1; Muslimi, el-Birr, 46–47)

2. Rriten gradët shpirtërore

“Po për secilin (njeri) ka shkallë (që do t'i arrijë) sipas asaj që ka vepruar.” (el-En'am, 6:132)

Nëse besimtarët nuk i arrijnë këto shkallë me adhurimet e tyre, Allahu u jep atyre një musibet, u dhuron durim dhe kështu u jep shpërblim pa masë (Zumer, 39:10). Për shkak

të musibetit, u falen mëkatet dhe, në këtë mënyrë, ata e arrijnë shkallën shpirtërore që e kanë tek Allahu xh.sh.

Hadithi me kuptimin: *“Nëse rob i nuk arrin me veprat e tij shkallën që Allahu e ka caktuar për të, Allahu e sprovon atë në jetën e tij, pasurinë ose fëmijën e tij; pastaj i dhuron durim dhe kështu e çon në shkallën që ia ka caktuar.”* (Ahmed b. Hanbel, Musned, V, 272), e shpreh qartë këtë të vërtetë. Në këtë hadith sqarohet ndikimi i durimit ndaj fatkeqësive në ngritjen e gradëve tek Allahu xh.sh.

Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka bërë të ditur se i Lartësuari Allah ka thënë:

“Kur Unë e sprovtoj robin Tim duke ia marrë të dy sytë dhe ai tregon durim, shpërblimi i tij tek Unë është xheneti.” (Buhariu, el-Merda, 7)

Musibetet që u ndodhin besimtarëve nuk janë të këqija, por janë të mira, sepse ato bëhen shkak që besimtarët të fitojnë sevape, t’u falen mëkatet dhe t’u rriten gradët shpirtërore. Kjo, megjithatë, është e mundur vetëm nëpërmjet durimit.

V. Marrëdhëniet shoqërore me personat me aftësi të kufizuara

Islami është fe që u kushton rëndësi të madhe marrëdhënieve shoqërore. Në këtë drejtim ai nuk bën dallim mes njerëzve të shëndetshëm dhe atyre me aftësi të kufizuara; përkundrazi, nxit që t'u kushtohet edhe më shumë vëmendje atyre që kanë nevojë për ndihmë, përkujdesje dhe mbështetje.

I dashuri Pejgamber s.a.v.s. vetë u ka dalë në ndihmë të sëmurëve, personave me aftësi të kufizuara, të paaftëve dhe nevojtarëve, duke u treguar dhembshuri e mëshirë. Ai na ka bërë të ditur se t'u tregosh rrugën personave me aftësi të kufizuara, t'i orientosh të verbrit, të komunikosh me personat me pengesa në dëgjim e në të folur në mënyrë që të kuptohen, si dhe t'ua plotësosh nevojat atyre që kanë nevojë, është sadaka në sytë e Allahut; dhe i ka pranuar personat me aftësi të kufizuara si anëtarë të natyrshëm të shoqërisë. (Ahmed b. Hanbel, *Musned*, II, 350; V, 154, 168–169)

H. Hatixheja r.a. e ka përshkruar Pejgamberin tonë të dashur me shprehjen *Tahmilu'l-kell*, që do të thotë *ai që merr mbi vete barrën e të pafuqishmit*. Termi *el-kell* përkufizohet si: njeri i paaftë që nuk është në gjendje ta

kryejë vetë punën e tij dhe që, për shkak të dobësisë e pafuqisë, ka nevojë për të tjerët. (Kâmil Miras, *Tecrîd-i Sarîh Tercümesi*, I, 12) Ky koncept përfshin çdo lloj aftësie të kufizuar. Ai dëshmon se Pejgamberi (s.a.v.s.), që para pejgamberisë, u qëndronte pranë të dobëtëve, të pafuqishmëve dhe të pambrojturve, dhe se ishte i angazhuar në lehtësimin e vështirësive dhe plotësimin e nevojave të tyre.



Veçanërisht në marrëdhëniet me personat me aftësi të kufizuara dhe me të sëmurët, duhet t'u kushtohet vëmendje këtyre çështjeve:

1. Personave me aftësi të kufizuara duhet t'u tregohet respekt dhe nderim

T'u tregosh respekt dhe vëmendje personave me aftësi të kufizuara dhe të sëmurëve, t'u japësh vlerë, t'i nderosh me fjalë dhe me sjellje, kontribuon në përmirësimin e gjendjes së tyre morale. Në jetën e Pejgamberit tonë të dashur shohim se ai ka treguar kujdes të veçantë në këtë drejtim. Itban b. Maliku, një sahabi nga Medina me pengesë në shikim, i cili kishte marrë pjesë në betejën e Bedrit, kur binte shi dhe errësohej nata, e kishte të vështirë të shkonte në xhami. Ai shkoi te Pejgamberi dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut! Unë jam me pengesë në shikim; kur errësohet dhe ka përmbytje, nuk mund të shkoj në xhami. A do të faleshe në shtëpinë time që unë ta bëj atë si një vend faljeje?” Pejgamberi s.a.v.s. shkoi në shtëpinë e Itbanit dhe i tha: “Ku dëshiron të falem?” Itbani ia tregoi vendin në shtëpi ku donte që Pejgamberi s.a.v.s. të falej. Ai u fal aty. (Buhariu, el-Edhan, 40) Më pas, Itbani u shërbeu Pejgamberit s.a.v.s. dhe shokëve të tij ushqim. (Buhariu, et-Tehexhhud, 36)

Ja pra, fakti që Pejgamberi s.a.v.s. iu përgjigj ftesës së një të verbri, shkoi në shtëpinë e tij, u fal në vendin që ai ia tregoi dhe hëngri nga ushqimi që iu ofrua, tregon përlulësinë e tij dhe interesimin e ngrohtë ndaj personave me aftësi të kufizuara.

2. Personat me aftësi të kufizuara duhet të vizitohen, t'u pyetet gjendja

Sidomos vizita e të sëmurëve ua gëzon zemrën dhe kontribuon në përmirësimin e gjendjes së tyre shëndetësore. Vizita e të sëmurit është një detyrë fetare dhe morale. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka thënë: *“Ushqeni të uriturit dhe vizitoni të sëmuret.”* (Buhariu, el-Merda, 4) Me këtë, ai kërkon përkujdesje ndaj nevojtarëve, personave me aftësi të kufizuara, të paaftëve dhe të sëmurëve.

Sipas asaj që ka transmetuar Pejgamberi s.a.v.s., i Lartësuari Allah në Ditën e Kijametit do të thotë:

- *O biri i Ademit! Unë u sëmura dhe ti nuk më vizitove.*

Njeriu do të përgjigjet:

- *O Zoti im! Ti je Zoti i botëve; si mund të të vizitoja?*

Allahu do të thotë:

- *A nuk e dije se filani, rob i Im, u sëmuri dhe ti nuk e vizitove?*

Sikur ta kishe vizituar, do të Më gjeje pranë tij.

- *O biri i Ademit! Të kërkoja ushqim dhe ti nuk Më ushqeve.*

Njeriu do të thotë:

- *O Zoti im! Ti je Zoti i botëve; si mund të të ushqeja?*

Allahu do të thotë:

- *A nuk e dije se filani, rob i Im, të kërkoj ushqim dhe ti nuk e ushqeve? Sikur ta kishe ushqyer, do të Më gjeje pranë tij.*

- *O biri i Ademit! Të kërkoja ujë dhe ti nuk Ma shuajta etjen.*

Njeriu do të thotë:

- *O Zoti im! Ti je Zoti i botëve; si mund të ta shuaja etjen?*

Allahu do të thotë:

- A nuk e dije se filani, robi Im, të kërkoj ujë dhe ti nuk i dhe?
Sikur t'ia kishe shuar etjen, do të Më gjeje pranë tij.
(Muslimi, el-Birr, 43)

Vizita e të sëmurit është një nga detyrat që një musliman
e ka ndaj muslimanit tjetër. (Muslimi, es-Selam, 3)



3. Duhet ndihmuar në çdo aspekt

Feja jonë nxit përkujdesjen dhe ndihmën ndaj personave me aftësi të kufizuara dhe të sëmurëve, duke e cilësuar këtë si një vepër me sevap. T'i tregosh rrugën një personi me pengesë në shikim, të kujdesesh për një person të shurdhër apo memec (Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, V, 168–

169), si dhe ta ndihmosh një person me aftësi të kufizuara të hipë në mjetin e tij, janë sadaka. (Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, II, 350)

Shokët e Pejgamberit tonë të dashur s.a.v.s. e kanë zbatuar këtë këshillë të fesë sonë. Për shembull, Abdurrahman Ibn Ka'bi r.a., pasi babai i tij e humbi shikimin, i shërbeu si udhërrëfyes dhe, kur vinte dita e xhuma, e çonte atë në xhami. (Ibn Maxhe, *el-Ikame*, 78)

Miku dhe mbrojtësi i vërtetë i të dobtëve, të rënëve, të varfërve dhe të mjerëve, Pejgamberi ynë s.a.v.s. – na ka bërë të ditur se çdo ndihmë dhe përkrahje që u jepet personave me aftësi të kufizuara është sadaka (lëmoshë).

Një ditë, Pejgamberi ynë s.a.v.s. foli për domosdoshmërinë e dhënies së sadakasë për çdo ditë. Sahabiu Ebu Dherr r.a. tha se nuk kishte mundësi të jepte sadaka çdo ditë. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. tha:

“Sadakaja ka shumë forma:

- *të thuash Allahu Ekber (Allahu është më i Madhi),*
- *të thuash Subhanallah (Allahun e pastroj nga çdo mangësi),*
- *të thuash La ilahe il-lallah (nuk ka zot tjetër përveç Allahut),*
- *të thuash Estagfirullah (kërkoj falje nga Allahu),*
- *të urdhërosh për të mirë dhe të ndalosh nga e keqja,*

- të largosh nga rruga e njerëzve gjembin, gurin apo kockën (çdo gjë që dëmton),
- t'i udhëzosh personat me pengesë në shikim,
- t'u shpjegosh të shurdhërve dhe memecëve në mënyrë që të kuptojnë,
- t'i tregosh rrugën atij që ka nevojë për të përmbushur një kërkesë,
- të vraposh për të ndihmuar të sëmurin që kërkon shërim,
- ta kapësh për krahun të dobët dhe ta ndihmosh,
- t'ia shprehësh mendimin atij që e ka të vështirë të flasë - të gjitha këto janë sadaka për veten tënde." (Ahmed b. Hanbeli, *Musned*, V, 168-169, 154)

Pejgamberi ynë s.a.v.s., duke theksuar se këto lloj ndihmash ndaj personave me aftësi të kufizuara janë sadaka, pra shprehje e *sadakatit* (besnikërisë) ndaj Allahut xh.sh., ka përfshirë ndër të mallkuarit edhe ata që e çorientojnë një person të verbër, duke e drejtuar qëllimisht në rrugë të gabuar. (Ahmedi, I, 217, 309, 317)

Allahu e ndihmon atë që i ndihmon njerëzit. "*Kush ia plotëson një nevojë vëllait të tij besimtar, Allahu do t'ia plotësojë atij një nevojë... Kush ia largon një gajle një muslimani, Allahu do t'ia largojë atij një gajle nga ato të Ditës së Kijametit.*" (Buhariu, el-Medhalim, 3)

"Besimtari është si një trup i vetëm. Nëse syri i tij ankohet, i gjithë trupi ndikohet prej kësaj; nëse koka e tij ka dhimbje, i

gjithë trupi ndikohet po ashtu.” (d.m.th. edhe besimtarët duhet të jenë të tillë) (Muslimi, el-Birr, 67)

4. Nuk duhet të përdoren fjalë poshtëruese dhe lënduese

Personat me aftësi të kufizuara dhe të sëmurët janë shumë të ndjeshëm. Edhe fjala më e vogël poshtëruese apo lënduese i prek ata thellë. Prandaj, shmangia e shprehjeve fyese dhe nënçmuese, veçanërisht në bisedat e drejtpërdrejta, është një detyrë islame.

Përdorimi i emërtimeve dhe i thirrjeve si: tullac, i verbër, i çalë e të ngjashme për njerëzit nuk janë aspak të drejta. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka përdorur shprehjet *i verbër, i shurdhër* dhe *memec* vetëm në kuptimin metaforik, si në hadithin: *“Dashuria e tepruar të bën të verbër dhe të shurdhër!”*, por kurrë nuk i ka përdorur këto fjalë për t’iu referuar ndonjë personi me aftësi të kufizuara. Përkundrazi, ai e ka kundërshtuar ashpër poshtërimin e njerëzve për shkak të veçorive të tyre fizike.

Kur Ebu Dherri r.a. e qortoi një skllav duke ia përmendur nënën e tij, Pejgamberi s.a.v.s. i tha: *“O Eba Dherr! A po e nënçmon atë për shkak të nënës së tij? Tek ti ende ka mbetur diçka nga injoranca (xhahilijeti). Ti je njeri që ende mban shenja të xhahilijetit (kulturës paraislame).”* (Buhariu, el-Iman, 22)

Me këtë, Pejgamberi s.a.v.s. tregoi qartë se një qëndrim i tillë nuk është i drejtë.

H.z. Aisheja r.a. tregon: “Një herë i thashë: *O i Dërguari i Allahut! Safija është (kaq e vogël).*” Aishja me dorë tregoi se ajo kishte për qëllim shtatin e shkurtër të Safijes. Atëherë Pejgamberi s.a.v.s. më tha: “*Ti the një fjalë të tillë saqë, sikur të përzihej me ujin e detit, do ta ndryshonte atë.*” (Tirmidhiu, el-Kijame, 51)

Këto transmetime tregojnë qartë se nënçmimi i një personi me aftësi të kufizuara apo thirrja e tij me mangësinë që ka, si dhe tallja apo qortimi i njerëzve të shëndetshëm për shkak të shtatit, ngjyrës apo mënyrës së të folurit, nuk është e drejtë. Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka ndërhyrë kundër këtyre sjelljeve dhe ka thënë: “*Mos u gëzo për fatkeqësinë e vëllait tënd dhe mos e përqesh atë, sepse Allahu mund ta mëshirojë atë dhe të të sprovtojë ty me të njëjtën gjë.*” (Tirmidhiu, el-Kijame, 54)

5. Duhet ofruar arsimim fetar dhe profesional

Sidomos arsimimi i personave me pengesa në shikim, dëgjim, të folur dhe në aftësi mendore, pajisja e tyre me një profesion, mësimi i njohurive fetare, si dhe po ashtu edukimi i familjarëve të personave me aftësi të kufizuara dhe të sëmurëve, janë jashtëzakonisht të rëndësishme.

Familjet duhet të veprojnë me vetëdije që të mos bëhen sebeb për lindjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara, që fëmijët e lindur të rriten shëndetshëm dhe të mos bëhen më vonë me pengesa e kufizime. Duhet shmangur martesat mes të afërmeve dhe, sidomos gjatë periudhës së

shtatzënisë, duhet të shmanget përdorimi i duhanit dhe i alkoolit.

Sa më herët të zbulohet një pengesë apo sëmundje dhe të fillohet trajtimi, aq më të mira janë rezultatet. Për këtë gjë familjet duhet të vetëdijesohen në mënyrë efikase. Suksesi i rehabilitimit varet edhe nga zhvillimi i aftësive terapeutike të prindërve.

Parandalimi i një pengese që e kërcënon individin, eliminimi ose zvogëlimi i pengesës ekzistuese, ndalimi i përkeqësimit të saj, ose lehtësimi i pasojave të saj - pavarësisht nga shkaku - janë detyrë e familjes dhe e shtetit. Në këtë drejtim, ndërgjegjësimi i familjeve është thelbësor, sepse roli i familjeve të vetëdijshme dhe të arsimuara është shumë i madh në gjetjen e një vendi të përshtatshëm në shoqëri për personat me aftësi të kufizuara, në përputhje me prirjet dhe aftësitë e tyre.

Pavarësisht të gjitha masave, nëse fëmija lind me aftësi të kufizuara ose bëhet i tillë më vonë, nuk duhet rënë në pikëllim të tepruar dhe as të shpërthehet në vajtime. Në një situatë të tillë, prindërit duhet të kërkojnë zgjidhje, të përpiqen për kujdesin dhe trajtimin, të tregojnë durim dhe, nëse është e nevojshme, të marrin ndihmë psikologjike dhe mbështetje arsimore nga shoqatat dhe institucionet përkatëse.



Fshehja e fëmijëve me aftësi të kufizuara nga shoqëria, turpërimi me ta, ndjenja e inferioritetit, si dhe ndërprerja e shtatzënisë (abortimi) nga frika se fëmija mund të lindë me aftësi të kufizuara, nuk janë sjellje të drejta. Njeriu duhet të jetë i kënaqur me atë që vjen nga Allahu xh.sh. Duhet të mendojë se kjo botë është një sprovë, se ata që e kalojnë me sukses sprovën do ta arrijnë shpërblimin hyjnor, dhe se përkujdesja ndaj personave që kanë nevojë për ndihmë është adhurim (ibadet) ndaj Allahut xh.sh. dhe një sevap i madh. Ndoshta pikërisht nëpërmjet kësaj, Allahu xh.sh. do ta fusë robin e Tij besimtar në xhenet.

Shtetit, institucioneve dhe organizatave publike, si dhe organizatave të shoqërisë civile, u takojnë përgjegjësi të

mëdha në fushën e arsimit dhe rehabilitimit të fëmijëve me aftësi të kufizuara dhe familjeve të tyre. Mbështetja e shoqatave dhe e fondacioneve që ofrojnë shërbime në këtë fushë (pa marrë parasysh përkatësinë fetare të tyre – R.N.) është një detyrë njerëzore, fetare dhe shoqërore.


6. Duhet të sigurohen mundësi punësimi

Familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara duhet të mbështeten psikologjikisht dhe shoqërisht, ndërsa personat me aftësi të kufizuara, që nuk janë në gjendje t'i plotësojnë vetë nevojat e tyre, duhet të përfshihen në skema të sigurimit social. Veçanërisht punëdhënësit dhe shteti duhet të sigurojnë mundësi punësimi për personat me aftësi të kufizuara, në mënyrë që ata të mos bëhen barrë për të tjerët dhe të mund të qëndrojnë vetë në këmbët e tyre.

Pejgamberi ynë s.a.v.s. ka thënë: *“Kush vdes dhe lë pasuri, ajo u takon trashëgimtarëve të tij; e kush lë pas njerëz që kanë nevojë për përkujdesje, përgjegjësia për ta më takon mua.”* (Buhariu, el-Feraiz, 25)

Me këtë fjalë, ai ka theksuar se ata që e drejtojnë shoqërinë duhet t'i mbrojnë dhe të kujdesen për të sëmurët, të dobët, personat me aftësi të kufizuara, jetimët dhe të gjithë ata që kanë nevojë për përkujdesje; njëkohësisht, u ka dhënë personave me aftësi të kufizuara detyra në jetën publike sipas aftësive të tyre, duke u përpjekur t'i integrojnë në shoqëri. Ai nuk i ka parë personat me aftësi të kufizuara si lypës që ua zgjatin dorën të tjerëve apo si një

shtresë joproductive e shoqërisë; përkundrazi, ka kërkuar që të përfitohet nga aftësitë e tyre në shërbime të ndryshme. Për shembull, Muadh b. Xhebelin r.a., i cili kishte pengesë ortopedike (i çalë, topall), e dërgoi *vali* (guvernator) në Jemen; po ashtu, sa herë që dilte nga Medina, e la trembëdhjetë herë si zëvendës të tij Abdullah b. Ummu Mektumin, i cili kishte pengesë në shikim. Gjatë periudhës së zëvendësimit, Ibn Ummu Mektumi i drejtonte namazet në xhami; për më tepër, si në Mekë ashtu edhe në Medinë, ai ka qenë për shumë vite myezin i Pejgamberit s.a.v.s. (Ibnu'l-Ethiri, *Usdu'l-Gabe*, IV, 264; Nesaiu, *es-Sunenu'l-Kebir*, V, 181, nr. 8605)



Sahabiu me pengesë në shikim, Itban b. Maliku, e ka ushtruar detyrën e imamit për fisin e tij. Me këto praktika të Pejgamberit s.a.v.s. mund të themi se synohej që personat me aftësi të kufizuara të punësoheshin në fusha të përshtatshme me aftësitë e tyre, të bëheshin individë prodhues, të integroheshin në shoqëri dhe të zhvillohej personaliteti i tyre; duke u bërë kështu edhe udhërrëfyes për brezat e ardhshëm.

Përfundim dhe vlerësim

Njeriu ose është person me aftësi të kufizuara, ose është i afërm i tij, ose është kandidat për t'u bërë i tillë. Prandaj, secili ka në një mënyrë apo tjetër lidhje me këtë "realitet". Nuk duhet pasur frikë nga ky realitet, por duhet të jemi të kujdesshëm dhe të përgatitur. Të dimë se çfarë duhet bërë dhe si duhet vepruar përballë tij, të informohemi dhe të ndërjegjësohemi për këtë, është detyra jonë themelore.

Allahu xh.sh. i vlerëson njerëzit sipas besimit, adhurimeve dhe sjelljeve të mira të tyre; Ai nuk i vlerëson sipas ndërtimit fizik, ngjyrës, racës, gjinisë, apo faktit nëse janë të shëndetshëm apo me aftësi të kufizuara.

Në Kur'an, është folur për pengesa në shikim, dëgjim, të folur, pengesa ortopedike dhe mendore, si dhe për sëmundjet në përgjithësi, si në jetën e kësaj bote ashtu edhe në botën tjetër - herë në kuptim të vërtetë, por kryesisht në kuptim metaforik.

Pengesat në kuptimin e vërtetë janë përmendur në kontekstin e krahasimit, lehtësimit në detyrimet fetare, trajtimit (shërimit) ose vlerësimit të njeriut.

Ndërsa pengesat në kuptimin metaforik përmenden për njerëzit që nuk besojnë, të cilët nuk i kuptojnë, nuk i

shohin, nuk i dëgjojnë dhe nuk i shprehin të vërtetat hyjnore. Në jetën e ahiretit, pengesat në shikim, dëgjim dhe të folur - në kuptim të vërtetë ose metaforik - nënkuptojnë se jobesimtarët do të jenë vërtet të verbër, të shurdhër e memecë, ose se nuk do të mund të shohin, të dëgjojnë dhe të flasin për gjërat që do t'i gëzonin apo të sillnin argumente në favor të tyre.

Njeriu, i krijuar në formën më të bukur (*ahsen-i takvim*), ka si detyrë themelore ta ruajë shëndetin e tij fizik dhe shpirtëror. Neglizhimi i kësaj detyre mund të çojë në shfaqjen e disa pengesave dhe paaftësive.

Nga ana tjetër, njeriu është në sprovë me jetën dhe vdekjen e tij. Ai ndonjëherë sprovohet me begati, e ndonjëherë me musibete. Prandaj, jo çdo vështirësi që i ndodh njeriut është domosdoshmërisht pasojë e fajit të tij personal. Krahës sprovës hyjnore, mund të ketë edhe pakujdesi e gabime nga ana e prindërve dhe e shoqërisë.

Qoftë si pasojë e një sprove hyjnore, qoftë për shkak të gabimeve të veta apo të të tjerëve, njeriu që përballet me një musibet duhet, para së gjithash, të tregojë durim dhe qëndrueshmëri. Kjo nuk e pengon atë të kërkojë zgjidhje materiale dhe shpirtërore për të dalë nga vështirësitë. Ai i kërkon zgjidhjet, por njëkohësisht e fiton qetësinë e brendshme duke thënë: *“Ky musibet ka ndodhur me lejen dhe caktimin e Allahut; po të mos kishte dashur Ai, nuk do të kishte ndodhur; dhe në këtë ka patjetër një gjë të mirë.”* Kjo vetëdije është fryt i besimit të njeriut në Allahun xh.sh..

Shumë njerëz, qoftë që nga lindja, qoftë më vonë si pasojë e një aksidenti të rëndë apo sëmundjeje, mund të mbeten të paralizuar, me aftësi të kufizuara ortopedike, ose me pengesa në dëgjim apo në shikim. Kush e di, ndoshta edhe ne, në një çast krejt të papritur, mund të bëhemi persona me aftësi të kufizuara ose të paaftë - Allahu na ruajttë! - syri që sheh të mos shohë më, veshi që dëgjon të mos dëgjojë, dora që kap të mos mbajë, këmba që ecën të mos ecë më. Prandaj, ndërkohë që i marrim masat e nevojshme për ta ruajtur shëndetin tonë, duhet të mos harrojmë se, si individë, si familje, si organizata të shoqërisë civile dhe si institucione publike, kemi përgjegjësi materiale dhe shpirtërore ndaj vëllezërve dhe motrave tona me aftësi të kufizuara.

Duhet t'u japim vlerë personave me aftësi të kufizuara, t'ua fitojmë zemrat me fjalët dhe sjelljet tona, dhe të bëhemi shkak për qetësinë dhe lumturinë e tyre. Duhet të marrim çdo masë materiale dhe shpirtërore që ua lehtëson jetën, t'i ofrojmë shërbimet e nevojshme infrastrukture, t'i ndihmojmë familjet që kanë fëmijë me aftësi të kufizuara dhe t'u ofrojmë atyre mbështetje arsimore dhe edukative. Duke shfrytëzuar maksimalisht mundësitë tona me qëllim që t'u sigurojmë vëllezërve tanë me aftësi të kufizuara mundësi punësimi, në mënyrë që t'ua dhurojmë atyre gëzimin e punës, të prodhimit dhe të fitimit të ndershëm.

Personave me aftësi të kufizuara duhet t'u sigurohet arsimimi i posaçëm, mundësia për punësim, të ndërtohen

marrëdhënie të mira me ta dhe të shmangen mënyrat e komunikimit që mund t'i lëndojnë ata - të gjitha këto janë përgjegjësi njerëzore dhe islame. Në këtë drejtim, nuk duhet ta etiketojmë asnjë person me aftësi të kufizuara me shprehje si “i verbër, i shurdhër, memec apo i çalë”, duhet të shmangim çdo fjalë, veprim apo sjellje poshtëruese dhe as në formë shakaje nuk duhet të tallemi me ta.

SERIA: "PROBLEMET TONA – PËRGJEGJËSITË TONA"

- *Të Drejtat e njeriut* - Dr. Burhan Erkuş
- *Dhuna dhe fëmijët tanë* - Elif Arslan
- *Jetimët e shoqërisë: Fëmijët e rrugës* - Dr. Havva Sula
- *Gruaja në një botë që ndryshon* - Dr. Hafsa Fidan
- *Harmonia familjare* - Dr. Zekiye Demir
- *Problemet e rinisë dhe vetëvrasja* - Dr. Şenol Korkut
- *Respekti ndaj të moshuarve* - Lamia Levent
- *Amaneti shoqëror: Personat me aftësi të kufizuara* - Doc. Dr. İsmail Karagöz
- *Feja, anarkia dhe terrori* - Dr. Yaşar Yiğit
- *Ndërgjegjësimi për mjedisin* - Ayla Abak
- *Etika e konsumit dhe shpërdorimi* - Dr. Muhlis Akar
- *Etika e punës dhe e tregtisë* - Dr. Muhlis Akar
- *Falsifikimi* - Dr. Bahattin Akbaş
- *Shterimi gjatë lojës: bixhozi* - Ayşenur Çalıkçı
- *Varësia nga substancat* - Dr. Ömer Menekşe

